

1. Ju lutem na vendosni në dispozicion sa ankesa për mosdhënie të informacionit të kërkuar janë paraqitur te Komisioneri për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Drejtave Personale prej krijimit të këtij institucioni deri më 15 shtator 2021? (ju lutem na i vendosni në dispozicion për çdo vit dhe numrin e ankesave. P.SH 2020 – 100 ankesa)
2. Ju lutem na vendosni në dispozicion numrin e ankesave që janë pranuar dhe refuzuar nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale për secilin vit nga krijimi i këtij institucioni deri më 15 shtator 2021.
3. Ju lutem na vendosni në dispozicion numrin e gjobave të vendosura nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ndaj koordinatorëve për të Drejtën e Informimit për mosdhënie të informacionit, për secilin vit prej krijimit të tij deri më 15 shtator 2021.
4. Ju lutem na vini në dispozicion se sa prej gjobave të vendosura ndaj koordinatorëve për të Drejtën e informimit të vendosura prej krijimit të institucionit tuaj deri më 15 shtator 2021 janë arkëtuar nga të gjobiturit. (Ju lutem na i vendosni të dhënat për secilin vit në dispozicion)
5. Ju lutem na vendosni në dispozicion se sa është koha mesatare e marrjes së përgjigjes së kërkuar nga institucioni ndaj të cilit është bërë kërkesa fillestare për informacion deri në përfundimin e procesit të ankimit.
6. A ka Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale statistikë se deri në çfarë mase zbatohet dhënia e informacionit në mënyrën e kërkuar nga kërkuesi i informacionit nga institucionet? Nëse po, ju lutem na e vendosni në dispozicion.
7. A është në dijeni Komisioneri për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale se institucione faturojnë pagesa për marrjen e informacionit të cilat nuk janë parashikuara në udhëzimet e Komisionerit për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale?

Në lidhje me dy pikat e para të kërkesës gjeni tabelën e mëposhtme:

Viti	Nr i ankesave	Pranuar	Refuzuar*
2014	26	26	0
2015	274	247	27
2016	684	583	101
2017	560	461	99
2018	820	678	142
2019	786	575	211
2020	715	532	183
2021**	604	469	145

*Refuzim përfshin numrin e ankesave jashtë objektit të ligjit, të paplota, jashtë afatit, të kufizuara sipas parashikimit të nenit 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit” dhe vendime mospranimi.

** Të dhënat për vitin 2021 janë përpunuar deri më datë 31.08.2021

Të dhënat e raportuara në tabelën e mësipërme mund të konsultohen lehtësisht nga qytetarët në faqen zyrtare www.idp.al pasi janë të publikura në raportet vjetore të Zyrës së Komisionerit. Kategori të tilla informacioni mund të sigurohen nëpërmjet “Programit të Transparencës” i parashikuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, i cili synon rritjen e transparencës proaktive nga ana e autoriteteve publike, marrjen e informacionit në kohë reale nga ana e kërkuarit, si dhe reduktimin e kostove administrative për trajtimin e kërkesave dhe ankesave për informacion.

Në lidhje me pyetjet 3 dhe 4, numri total i sanksione administrative me gjobë për cënim të të drejtës për informim gjatë periudhës 2014 – 15 shtator 2021 është 26 në total nga të cilat 4 sanksione administrative me gjobë janë vendosur për Koordinatorët për të Drejtën e Informimit. Për më shumë informacion gjeni tabelën e mëposhtme:

Viti	Nr. Sanksione	Rrezuar nga Gjykata	Ekzekutuar
2015	2	1	1
2016	2	2	0
2017	6	2 (1 koordinator)	3 + 1 parashkruar (1 koordinator)
2018	3	1	2
2019	5	3 (1 koordinator)	2 (1 koordinator)
2020	3	2	1 në proces
2021***	5	2	3 në proces

** Të dhënat për vitin 2021 janë përpunuar deri më datë 15.09.2021

Në lidhje me pyetjen 5 dhe 6 Zyra e Komisionerit nuk e disponon informacionin e kërkuar pasi mbledhja e të dhënave nuk është parashikuar në kuadrin rregullator.

Në lidhje me pyetjen 7 ju informojmë se Zyra e Komisionerit ka marrë ankesa nga qytetarë ose përfaqësues të shoqërisë civile për aplikimin e tarifave të vendosura nga Autoriteti Publik për riprodhimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 13 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife të përcaktuar dhe të bërë publike më parë. Tarifa nuk mund të jetë më e lartë së kostoja reale e materialit mbi të cilin riprodhohet informacioni.

Ndërkohë, në pikën 3, të nenit 13 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikohet se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shqyrton periodikisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, tarifat e bëra publike nga autoritetet publike dhe, sipas rastit, urdhëron ndryshimin e tyre”*. Bazuar në këtë parashikim, Zyra e Komisionerit në bashkëpunimin dhe me Ministrinë e Financeve dhe Ekonomisë ka marrë në shqyrtim apo janë në proces 5 raste lidhur me problematika për përcaktimin e koston së riprodhimit të dokumentacionit nga autoritetet publike, në raport me koston reale të materialit mbi të cilin riprodhohet informacioni.